



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE**

**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË SISTEMEVE, MENAXHIMIT TË ZIN, PROJEKTEVE
TIK DHE MENAXHIMIT TË SISTEMEVE TË INFORMACIONIT**

Nr. ____ Prot.

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL MBI HARTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: "Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)"

I mbajtur sot me datë ____ . ____ .2026, në Bashkinë Shkodër, nga personat përgjegjës mbi përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)", në zbatim të Urdhrit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 161, datë 13.02.2026, si dhe bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, neni 2, neni 74, pika 4, dhe Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 36 "Specifikimet teknike".

Specifikimet teknike janë hartuar duke pasur parasysh nevojat funksionale të Bashkisë Shkodër dhe zërat buxhetorë përkatës për blerje pajisjesh TIK. Ato janë formuluar si kërkesa minimale teknike, me qëllim garantimin e cilësisë së mallrave, përputhshmërisë funksionale dhe konkurrencës së hapur. Çdo referencë teknike interpretohet si minimum funksional ose ekuivalent.

Nr.	Pajisja	Sasia	Specifikime teknike minimale
1	Aparat fotografik mirrorless, full-frame, për foto/video profesionale	1	Aparat fotografik mirrorless me sensor full-frame; rezolucion efektiv sensor ≥ 45 MP; stabilizim në trup/sensor-shift; ISO bazë të paktën 100-51.200 ose më i gjerë; regjistrim video deri në DCI/UHD 8K; dalje video 4:2:2 10-bit deri në 4K; të paktën 2 slotë karte, ku një CFexpress Type B ose ekuivalent me shpejtësi të lartë dhe një SD/SDHC/SDXC UHS-II; HDMI, hyrje mikrofoni 3.5 mm, dalje kufje 3.5 mm, USB-C për të dhëna/karikim, Wi-Fi/Bluetooth; ekran LCD me prekje të artikulueshëm; bateri dhe karikues bazë të përfshirë.
2	Lente wide-angle për aparatin fotografik	1	Lente wide-angle për aparatin fotografik të ofruar; fokus 16 mm ose ekuivalent për sensor full-frame; hapje maksimale f/2.8 ose më e madhe; fokus automatik; kënd pamjeje të gjerë $\geq 100^\circ$ ose ekuivalent; distancë minimale fokusimi ≤ 15 cm ose ekuivalente; mount i njëjtë/kompatibil me

			aparatin fotografik të ofruar, pa humbje të funksioneve kryesore.
3	Lente prime standard për aparatin fotografik	1	Lente prime/standard për aparatin fotografik të ofruar; fokal 50 mm ose ekuivalent; hapje maksimale f/1.2 ose më e madhe; fokus automatik; mbulim full-frame; elementë optikë të përshtatshëm për foto/video profesionale; mount i njëjtë/kompatibil me aparatin fotografik të ofruar, pa humbje të funksioneve kryesore.
4	Bateri shtesë për aparatin fotografik	3	Bateri shtesë për aparatin fotografik të ofruar; tip lithium-ion; kompatible plotësisht me aparatin fotografik; kapacitet minimal sipas standardit të prodhuesit për modelin e ofruar, preferueshëm ≥ 2130 mAh ose ekuivalent; të reja dhe të pajisura me mbrojtje sigurie.
5	Aparat për filmim mirrorless	1	Aparat për filmim mirrorless; sensor Four Thirds/Micro Four Thirds ose ekuivalent, rezolucion efektiv ≥ 25 MP; stabilizim 5-aksial në trup; regjistrim video 5.7K deri në 30 fps dhe 4K/DCI 4K deri në 60 fps ose më shumë; 10-bit 4:2:2 ose ekuivalent; mundësi slow motion; slote CFexpress Type B dhe SD UHS-II ose ekuivalente; HDMI, hyrje mikrofon 3.5 mm, dalje kufje 3.5 mm, USB-C, Wi-Fi/Bluetooth; ekran me prekje të lëvizshëm; bateri dhe karikues bazë të përfshirë.
6	Lente wide për aparatin e filmimit mirrorless	1	Lente wide për aparatin e filmimit të ofruar; fokal 9 mm në Micro Four Thirds ose 18 mm ekuivalent 35 mm, ose më i gjerë; hapje maksimale f/1.7 ose më e madhe; fokus automatik; kënd pamjeje $\geq 100^\circ$ ose ekuivalent; distancë minimale fokusimi ≤ 10 cm ose ekuivalente; mount i njëjtë/kompatibil me aparatin e filmimit të ofruar.
7	Dron për filmim video	1	Dron për filmim video; kamerë me sensor $\geq 1''$ CMOS ose ekuivalent; foto ≥ 50 MP në JPEG/RAW ose ekuivalent; video UHD 4K ≥ 120 fps dhe Full HD ≥ 240 fps ose ekuivalent; gimbal stabilizues 3-aksial; sistem shmangieje pengesash me sensorë shumëdrejtimësh/omnidirectional; Remote ID ose funksion identifikimi sipas standardeve të aplikueshme; kohë fluturimi ≥ 45 minuta në kushte standarde; kontrollues i përfshirë; GNSS; slot microSD; karikues dhe aksesore bazë të përfshirë. Përdorimi operacional i dronit kryhet nga Autoriteti Kontraktor sipas legjislacionit në fuqi.
8	Kartë memorie CFexpress Type B, 512 GB	2	Kartë memorie CFexpress Type B; kapacitet 512 GB; shpejtësi leximi maksimale ≥ 1700 MB/s; shpejtësi shkrimi maksimale ≥ 1400 MB/s; e përshtatshme për regjistrim video me bitrate të lartë dhe kompatible me pajisjet e ofruara.

9	Bateri shtesë për aparatin e filmimit mirrorless	4	Bateri shtesë për aparatin e filmimit të ofruar; lithium-ion; kapacitet ≥ 2200 mAh ose ekuivalent sipas modelit të ofruar; tension sipas sistemit të kamerës; kompatible plotësisht me aparatin e filmimit; të reja dhe të pajisura me mbrojtje sigurie.
10	Hard disk 12 TB për arkiv video/foto	2	Hard disk për arkivim video/foto; kapacitet 12 TB; format 3.5"; ndërfaqe SATA III ose ekuivalent; shpejtësi 7200 rpm; klasë NAS/arkivim profesional; shpejtësi leximi/shkrimi ≥ 250 MB/s ose ekuivalent; i përshtatshëm për ruajtje afatgjatë të materialeve foto/video; i ri, i papërdorur dhe me garanci.
11	Aparat fotografik mirrorless, full-frame, për foto/video profesionale	1	kamerë mirrorless full-frame CMOS Full-Frame (35.6 x 23.8 mm) me rezolucion ≥ 24.2 Megapiksel pa filtër Low Pass. Ndjeshmëria ISO: ISO 100 - 51,200 $\geq$ ISO 50 deri në 204,800 për foto) Rezolucioni Maksimal: Regjistrim i plotë i sensorit 6K Open Gate (3:2) $\geq 30p$ (10-bit 4:2:0) ose ekuivalente; Regjistrim 4K / C4K: Deri në 4K 60p/50p pa limit kohor regjistrimi Dy slot-e për karta memorie, të dyja të pajtueshme me SD UHS-II. $\geq$ ose ekuivalent bateri dhe karikues bazë të përfshirë.
12	lentë standard zoom e gjeneratës së dytë për aparatet fotografike mirrorless me sensor Full-Frame	1	Distanca fokale: 24–70 mm Hapja maksimale e diafragmës: $\geq f/2.8$ ose ekuivalent (konstante në të gjithë diapazonin zoom) Hapja minimale e diafragmës: $f/22$ Këndi i shikimit (në Full-Frame): $\geq 84.1^\circ - 34.3^\circ$ ose ekuivalent
13	stabilizues profesional dhe i lehtë për kamera	2	Kapaciteti i Ngarkesës ≥ 3.0 kg ose ekuivalent Bateria dhe Autonomia ≥ 14 orë punë ose ekuivalent, Gama Mekanike e Boshteve 3-Axis, Rrotullimi Horizontal: 360° rrotullim i vazhdueshëm, Animi: -95° deri në $+240^\circ$ Pjerrësia : -112° deri në $+214^\circ$ Battery Grip dhe gjitha aksesoret shtese bateri dhe karikues bazë të përfshirë.
14	Kamera xhepit për vlogging dhe krijimin e përmbajtjeve kinematografike	2	1-inch CMOS me performancë të lartë në dritë të ulët Hapja e lentës : $f/2.0$ me distancë fokusi nga 0.2 m deri në infinit Këndi i lentës: Ekuivalent me 20 mm Diapazoni dinamik : 14 stopa për detaje maksimale në hije dhe dritë të fortë Profilet e ngjyrave: 10-bit D-Log Zoom: $2\times$ pa humbje cilësie deri në $4\times$ Zoom Dixhital Rezolucioni i Fotos: Deri në 37 MP në formatet JPEG dhe RAW Video standarde: Deri në 4K (16:9) në 60fps. □ Bitrate maksimal: 180 Mbps.Stabilizimi: Mekanik me 3 akse (Gimbal).Rrotullimi i Gimbalit: Pan: -235° deri $+58^\circ$ / Tilt: -120° deri $+70^\circ$ / Roll: -45° deri $+45^\circ$ dhe gjitha aksesoret bateri dhe karikues bazë të përfshirë.

15	Kartë memorie SDXC 128GB	4	Kapaciteti: 128 GB Lloji i kartës: SDXC Klasa e memories: Class 10 Lloji i memories së brendshme: UHS-I Shpejtësia e leximit: 200 MB/s Shpejtësia e shkrimit: 90 MB/s Klasa e shpejtësisë UHS: Class 3 (U3) Klasa e shpejtësisë së videos: V30
16	Kartë memorie microSDXC 128 GB	4	Kapaciteti: 128 GB Formati (Madhësia): microSDXC Klasa e memories: Class 10 Shpejtësia sekuenciale e leximit: Deri në 160 MB/s Shpejtësia sekuenciale e shkrimit: Deri në 90 MB/s Ndërfaqja UHS-I Klasat e Shpejtësisë Video & Aplikacionit: C10, U3, V30, A2
17	Karikues për bateri Lithium-Ion Bateri 7.2V, 2200mAh	2	Lloji i karikuesit: Karikues me 1 vend për 1 bateri Pajtueshmëria (Kompabiliteti): Lithium-Ion Bateri 7.2V, 2200mAh Hyrja/Dalja e energjisë: 1x Hyrje USB-C (Femër) Përshtatësi/Kablloja e përfshirë: Lloji A/B në USB-C (Mashkull) Voltazhi i daljes së folesë: 5 V DC në 1.8A Indikatorit: Dritë treguese e statusit
18	Printer portativ	10	Teknologjia: Direct thermal, pa bojë Letra 58 mm minimum; 80 mm më mirë për gjoba me tekst të gjatë. Rezolucioni: 203 dpi Shpejtësia 60–90 mm/s ose më shumë. Bateria: 1,500 mAh minimum; më mirë 2,000 mAh+ ose bateri e ndërrueshme Lidhja: Bluetooth + USB Komanda ESC/POS ose SDK Android QR/barcode. Duhet të printojë QR code ose imazh Terren Kapëse rripi, kasë mbrojtëse, sensor letre, spare battery nëse ka. Gjuha shqipe: “ë” dhe “ç”
19	Tablet	10	Procesori “Processor Cores”: Octa Core “RAM”: 4 GB Memorie e Brendshme “Internal Memory”: 64 GB “Removable Memory”: Të Suportojë Kartë Memorie “Sensors”: Accelerometer, etj GPS-Internal Ekran “Display”: ≥ 10” (1200 x 1920) multitouchscreen Bateria “Battery”: 7000 mAh ose min. 4 Orë Punë Kamera “Camera”: Kamera para min. 5 Megapixel Kamera kryesore min. 8 Megapixel KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Portat e Komunikimit “Ports”: USB Tipi C ose ekuivalent Rrjeti “Networking”: 3G; 4G/LTE ; 5G Wireless 802.11ac (Kompatabël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V5.3; Sistemi i Operimit i Instaluar “Preinstalled Licensed O. S.”: Po AKSESORËT Ushqyesi “Recharger”: Po, European 220 V AC, 50 Hz Flip Cover: Po Laps për tabletin Po (jo detyrimisht i të njëjtës markë me tabletin) GARANCIA Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”: 1 Vit
20	PRINTER Color Standard	1	Shpejtësia e Printimit me Ngjyra “Color Print Speed” A4: ≥ 25 ppm Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”: 20 000 Faqe Teknologjia “Technology”: Laser Rezolucioni i Printimit

			minimal "Print Quality": 600x600 dpi Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity": 250 Fletë Pesha Specifike e Letrës "Media Sizes": 60-120 g/m ² Formati i Letrës "Media format": A4/A5/Envelope Aftësia e Printimit Duplex: Po Memorja "Memory": ≥ 256 MB "Toner": Shoqëruar me Starter Kit KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Porta e Komunikimit "Interface": High Speed USB 2.0 "Ethernet": Po AKSESORËT Kabëll "Power Cord": Po, European Software/Drivers CD: Po Kabëll USB: Po GARANCIA Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty": 2 Vjet
--	--	--	--

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojën konkrete për furnizim me pajisje TIK dhe pajisje ndihmëse, duke respektuar parimet e barazisë, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

Personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike: